



Republika e Kosovës
Republika Kosova
Republic of Kosovo



Zyra Kombëtare e Auditimit
Nacionalna Kancelarija Revizije
National Audit Office

**RAPORTI I AUDITIMIT PËR PASQYRAT FINANCIARE PËR
GJYKATËN KUSHTETUESE TË KOSOVËS
PËR VITIN 2019**

Prishtinë, qershor 2020

Zyra Kombëtare e Auditimit e Republikës së Kosovës është institucioni më i lartë i kontrollit ekonomik e financiar dhe për punën e vet i jep llogari Kuvendit të Republikës së Kosovës.

Raportet e Zyrës Kombëtare të Auditimit promovojnë llogaridhënien e institucioneve publike, duke ofruar bazë të qëndrueshme për të kërkuar llogari nga menaxherët e çdo organizate të audituar. Në këtë mënyrë, ne rrisim besimin në shpenzimin e fondeve publike dhe luajmë një rol aktiv në sigurimin e interesit të taksapaguesve dhe të palëve tjera të interesit në rritjen e përgjegjësisë publike.

Ky auditim është kryer në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Institucioneve Supreme të Auditimit, si dhe me praktikat e mira evropiane.

“ETIKA Co” Shpk ka kryer auditimin e Pasqyrave Financiare Vjetore të Gjykatës Kushtetuese të Kosovës për vitin e përfunduar më 31 dhjetor 2019, në emër të Zyrës Kombëtare të Auditimit të Republikës së Kosovës.

Auditori i Përgjithshëm ka vendosur në lidhje me opinionin e auditimit për Pasqyrat Financiare Vjetore të Gjykatës Kushtetuese të Kosovës, në konsultim me menaxherin e kontratës Mujë Gashi, i cili e ka mbikëqyrur auditimin.

Raporti është rezultat i auditimit të kryer nga ETIKA Co shpk, nga Fatmir Mehmeti, udhëheqës i ekipit si dhe Burim Selmani, anëtar i ekipit.


TABELA E PËRMBAJTJES

Përmbledhje e përgjithshme.....	4
Fushëveprimi dhe metodologjia e auditimit.....	5
1 Opinioni i auditimit për Pasqyrat Financiare Vjetore	6
2 Menaxhimi financiar dhe kontrolli	7
3 Progresi në zbatimin e rekomandimeve.....	10
Shtojca I: Shpjegim i llojeve të ndryshme të opinioneve të aplikuara nga ZKA-ja.....	12
Shtojca II: Letërkonfirmimi.....	14

Përmbledhje e përgjithshme

Raporti i përmbledhë çështjet kryesore që dalin nga auditimi i Gjykatës Kushtetuese të Kosovës për vitin 2019, i cili përfshin Opinionin e Auditorit të Përgjithshëm për Pasqyrat Financiare Vjetore. Ekzaminimi i Pasqyrave Financiare për vitin 2019 është kryer në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Institucioneve Supreme të Auditimit (SNISA).

Auditimi është fokusuar në:



Konkluzionet

Procesi i përgatitjes së Pasqyrave Financiare Vjetore ishte menaxhuar në pajtim me legjislacionin në fuqi.

Menaxhimi financiar dhe kontrolli në GJKK kishte kontrolle të mira në raport me obligimet statutorë të saj. Ajo reflekton rishikim cilësor dhe siguri në implementimin e legjislacionit në fuqi.

Zbatimi i rekomandimeve nga viti i kaluar - GJKK kishte adresuar të gjitha rekomandimet nga viti i kaluar.

Opinion i Auditorit të Përgjithshëm¹

Opinion i pamodifikuar

Pasqyrat Financiare Vjetore për vitin e përfunduar më 31 dhjetor 2019, prezantojnë një pamje të drejtë dhe të vërtetë në të gjitha aspektet materiale.

Më gjerësisht shih kapitullin 1 të këtij raporti.

Përgjigja e menaxhmentit në auditimin 2019

Menaxhmenti i GJKK-së është pajtuar me konkluzionet e auditimit.

Zyra Kombëtare e Auditimit vlerëson bashkëpunimin e menaxhmentit dhe personelit të Gjykatës Kushtetuese të Kosovës gjatë procesit të auditimit.

¹ Shtojca I, shpjegon llojet e opinioneve, sipas SNISA-ve.

Fushëveprimi dhe metodologjia e auditimit

Auditimi përfshin ekzaminimin dhe vlerësimin e pasqyrave financiare dhe të dhënave të tjera financiare, me sa vijon:

- Nëse pasqyrat financiare japin një pamje të drejtë dhe të vërtetë të llogarive dhe çështjeve financiare për periudhën e auditimit;
- Nëse të dhënat financiare, sistemet dhe transaksionet janë në pajtim me ligjet dhe rregulloret në fuqi;
- Nëse funksionet e kontrollit dhe të auditimit të brendshëm janë të përshtatshme dhe efikase; dhe
- Nëse janë ndërmarrë veprimet e duhura për zbatimin e rekomandimeve të auditimit.

Auditimi është bazuar në vlerësimin e rrezikut. Kemi analizuar veprimtarinë e Gjykatës Kushtetuese të Kosovës (GJKK), nivelin e mbështetjes në kontrollet menaxheriale për të përcaktuar nivelin e testeve të hollësishme, që janë të nevojshme për të siguruar dëshmitë dhe që e mbështesin opinionin e AP-së.

Procedurat kanë përfshirë rishikimin e kontrolleve të brendshme, të sistemeve të kontabilitetit, teste të ndërlidhura substanciale, si dhe aranzhimet e ndërlidhura të qeverisjes deri në masën që i kemi konsideruar të nevojshme për kryerjen efektive të auditimit. Gjetjet e auditimit nuk duhen të konsiderohen si një pasqyrë gjithëpërfshirëse e dobësive që mund të ekzistojnë apo e të gjitha përmirësimeve që mund të bëhen në sistemet dhe procedurat që janë aplikuar.

Kapitujt në vijim ofrojnë përshkrim të detajuar të gjetjeve dhe rekomandimeve në çdo fushë të audituar. Përgjigjet e menaxhmentit në rezultatet e auditimit mund të gjenden në Shtojcën II .

1 Opinioni i auditimit për Pasqyrat Financiare Vjetore

Ne kemi kryer auditimin e PFV-ve të Gjykatës Kushtetuese të Kosovës (GJKK) për vitin e përfunduar me 31 dhjetor 2019, në përputhje me Ligjin e ZKA-se dhe Standardet Ndërkombëtare të Institucioneve Supreme të Auditimit. Ekzaminimet e auditimit janë kryer për të mundësuar dhënien e opinionit për PFV, të cilat përfshijnë pasqyrën e pranimeve dhe të pagesave në para të gatshme dhe pasqyrën e ekzekutimit të buxhetit, të shpalosura në detaje.

Opinion i pamodifikuar

Sipas opinionit tonë, Pasqyrat Financiare Vjetore për vitin e përfunduar më 31 dhjetor 2019, prezantojnë një pamje të drejtë dhe të vërtetë në të gjitha aspektet materiale, në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Kontabilitetit për Sektorin Publik, sipas kontabilitetit të bazuar në para të gatshme.

Baza për opinion

Auditimi është kryer në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Institucioneve Supreme të Auditimit (SNISA). Sipas këtyre standardeve, përgjegjësitë tona janë përshkruar më poshtë tek pjesa 'Përgjegjësitë e Auditorit për Auditimin e Pasqyrave Financiare'. Në përputhje me SNISA-t 10 dhe 30, si dhe kërkesat e tjera relevante për auditimin e PFV-ve të organizatave buxhetore, ZKA-ja është e pavarur nga GJKK-ja. Besojmë se dëshmitë e auditimit që kemi marrë janë të mjaftueshme dhe të duhura për sigurimin e bazës për opinionin.

Përgjegjësia e menaxhmentit për PFV-të

Sekretari i Përgjithshëm dhe Zyrtaari Kryesor Financiar përgjegjës për përgatitjen dhe prezantimin e drejtë të Pasqyrave Financiare sipas Standardeve Ndërkombëtare të Kontabilitetit në Sektorin Publik - Raportimi Financiar bazuar në Kontabilitetin e Parasë së Gatshme. Po ashtu, menaxhmenti është përgjegjës edhe për vendosjen e kontroleve të brendshme, të cilat i përcakton si të nevojshme për të mundësuar përgatitjen e Pasqyrave Financiare, pa keq deklarime materiale të shkaktuara, qoftë nga mashtrimi apo gabimi. Kjo përfshinë përmbushjen e kërkesave që burojnë nga Ligjit nr. 03/L-048 për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësitë (me plotësime dhe ndryshime) dhe Rregullorja nr. 01/2017 për Raportim Vjetor Financiar nga Organizata Buxhetore.

Sekretari i Përgjithshëm është përgjegjës për të siguruar mbikëqyrjen e procesit të raportimit financiar të GJKK-së.

Përgjegjësia e Auditorit të Përgjithshëm për auditimin e PFV-ve

Përgjegjësia jonë është që të shprehim një opinion për PFV-të në bazë të auditimit të kryer, në përputhje me SNISA-t. Këto standarde kërkojnë që të marrim siguri të arsyeshme se pasqyrat financiare nuk përmbajnë keqdeklarime materiale.

Siguria e arsyeshme është një nivel i lartë i sigurisë, por nuk garanton se një auditim i kryer në pajtim me SNISA-t do të zbulojë çdo keq-deklarim material që mund të ekzistojë. Keqdeklarimet mund të rezultojnë nga mashtrimi ose gabimi dhe konsiderohen materiale nëse, individualisht ose së bashku, mund të ndikojnë në vendimet e marra mbi bazën e këtyre PFV-ve.

Auditimi përfshinë kryerjen e procedurave për të marrë dëshmi në lidhje me informatat financiare dhe shpalosjet në PFV. Procedurat e zgjedhura varen nga gjykimi i auditorit, duke përfshirë edhe vlerësimin e rreziqeve nga keqdeklarimet materiale në PFV, qoftë për shkak të mashtrimit apo gabimit. Gjatë vlerësimit të rrezikut, auditori merr në konsideratë kontrollin e brendshëm që është relevant në përgatitjen e pasqyrave financiare nga entiteti, në mënyrë që të dizajnojë procedura të auditimit që janë të përshtatshme për rrethanat e entitetit, por jo për qëllim të shprehjes së opinionit mbi efektivitetin e kontroleve të brendshme të entitetit.

Auditimi përfshinë edhe vlerësimin e përshtatshmërisë së politikave kontabël të përdorura, arsyeshmërinë e përlogaritjeve kontabël të bëra nga menaxhmenti, si dhe vlerësimin e prezantimit të pasqyrave financiare.

Ne komunikojmë me menaxhmentin e entitetit të audituar në lidhje me fushëveprimin, kohën e planifikuar të auditimit dhe gjetjet e rëndësishme të auditimit, përfshirë ndonjë mangësi të rëndësishme në kontrollin e brendshëm që ne e identifikojmë gjatë auditimit.

Raporti i auditimit publikohet në webfaqen e ZKA-së, me përjashtim të informacioneve që klasifikohen si sensitive apo për shkak të ndalesave të tjera ligjore e administrative, në pajtim me legjislacionin në fuqi.

2 Menaxhimi financiar dhe kontrolli

Puna jonë lidhur me Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin (MFK) pasqyron aktivitetet e detajuara të auditimit për sistemet e të hyrave dhe shpenzimeve në organizatat buxhetore. Në mënyrë të veçantë, kemi trajtuar menaxhimin e buxhetit, prokurimin, burimet njerëzore dhe pasuritë e detyrimet si dhe funksionin e auditimit të brendshëm.

Konkluzioni për menaxhimin financiar dhe kontrollin

GJKK lidhur me menaxhimi financiar dhe kontrolli ka kontrole të mira në raport me obligimet statutores të saj. Ajo reflekton rishikim cilësor dhe siguri në implementimin e legjislacionit në fuqi.

2.1 Planifikimi dhe realizimi i buxhetit

Ne i kemi shqyrtuar burimet e fondeve buxhetore dhe shpenzimet e fondeve sipas kategorive ekonomike. Kjo është paraqitur në tabelat e mëposhtme:

Tabela 1. Burimet e fondeve buxhetore (në €)

Përshkrimi	Buxheti fillestar	Buxheti Final ²	2019 Realizimi	% e Realizimit 2019	2018 Realizimi	2017 Realizimi
Burimet e Fondeve:	1,868,447	1,957,758	1,957,336	100%	1,697,491	1,527,569
Granti i Qeverisë - Buxheti	1,868,447	1,957,724	1,957,336	100%	1,697,491	1,505,146
Donacionet e jashtme	-	34	-	-	-	22,423

Buxheti final në raport me buxhetin fillestar ishte rritur për 89,311€. Kjo rritje është rezultat i kërkesave nga GJKK për mbulimin e shpenzimeve dhe vendimeve të Qeverisë.

Në vitin 2019, GJKK-ja ka shpenzuar pothuajse 100% të buxhetit final ose 1,957,336€, me një shpenzim të njëjtë krahasuar me vitin 2018. Megjithatë, se si ishte realizuar buxheti sipas kategorive janë dhënë shpjegimet në tabelën në vijim.

Tabela 2. Shpenzimet e fondeve sipas kategorive ekonomike (në €)

Përshkrimi	Buxheti fillestar	Buxheti Final	2019 Realizimi	% e Realizimit 2019	2018 Realizimi	2017 Realizimi
Shpenzimet e fondeve sipas kategorive ekonomike:	1,868,447	1,957,758	1,957,336	100%	1,697,491	1,527,569
Pagat dhe Mëditjet	1,187,745	1,288,022	1,288,022	100%	1,137,867	998,706
Mallrat dhe Shërbimet	491,702	420,520	420,473	100%	512,184	500,301
Shërbimet komunale	4,000	3,000	2,652	88%	3,246	3,562
Investimet Kapitale	185,000	246,216	246,189	100%	44,195	25,000

Shpjegimet rreth ndryshimeve në kategoritë buxhetore:

- Kategoria e pagave dhe mëditjeve ishte rritur në raport me buxhetin fillestar për vlerën 100,277€;
- Në raport me buxhetin fillestar kategoria e mallrave dhe shërbimeve ishte zvogëluar për vlerën 71,182€;
- Buxheti i komunalive ishte zvogëluar për vlerën 1,000€; si dhe
- Buxheti i investimeve kapitale ishte rritur në raport me buxhetin fillestar për vlerën 61,216€.

² Buxheti Final – buxheti i aprovuar nga Kuvendi i përshtatur më pas nga Ministria e Financave

Ndryshimet buxhetore ishin si rezultat i kërkesave të GJKK-së për mbulimin e shpenzimeve për paga si dhe investimeve kapitale në objektin e GJKK-së, sipas vendimeve të Qeverisë Nr 02/113 të datës 05.11.2019 dhe vendimit Nr 03/115 të datës 17.12.2019.

2.1.1 Pagat dhe mëditjet

Buxheti final për paga dhe mëditje është 1,288,022€, aq sa edhe ishin shpenzuar. Numri i të punësuarve sipas buxhetit ishte 70 ndërsa në fund të vitit numri i tyre ishte 69. Gjatë vitit 2019 ishin punësuar 4 të rinj. Kemi testuar 35 mostra për teste substanciale në vlerë 92,693€, si dhe 15 mostra për teste të pajtueshmërisë. Nga mostrat e testuar nuk kemi vërejtur ndonjë mangësi domethënëse për raportim.

2.1.2 Mallrat dhe shërbimet (përfshirë komunalitë)

Buxheti final për mallra dhe shërbime në vitin 2019 ishte 420,520€, prej tyre ishin shpenzuar 420,473€. Ndërsa buxheti final për komunalitet ishte 3,000€, prej të cilave ishin shpenzuar 2,652€. Ato kanë të bëjnë me shpenzimet e udhëtimit zyrtar, shpenzime për botime, shpenzime për mirëmbajtje, furnizime për zyrë, shërbime tjera kontraktuese, shpenzime të telefonit dhe shpenzime të tjera.

Kemi testuar 39 mostra për teste substanciale në vlerë 159,837€ si dhe 12 mostra për teste të pajtueshmërisë. Nga mostrat e testuar nuk kemi vërejtur ndonjë mangësi domethënëse për raportim.

2.1.3 Investimet kapitale

Buxheti final për investime kapitale ishte 246,216€, prej tyre në 2019 ishin shpenzuar 246,189€. Ato kanë të bëjnë me investime kapitale në objektin ekzistues, blerje të vetura zyrtare, blerjen e një softueri dhe serveri për pajisje të IT.

Kemi testuar 2 mostra për teste substanciale në vlerë 131,529€, si dhe 4 mostra për teste të pajtueshmërisë. Nga mostrat e testuar nuk kemi vërejtur ndonjë mangësi domethënëse për raportim.

2.2 Pasuritë kapitale dhe jokatitale

Vlera e paraqitur në PFV e pasurive kapitale është 287,476€, pasurive jokatitale është 58,734€, si dhe e stokeve 7,161€. Kemi testuar 47 mostra për teste substanciale në vlerë 153,017€, si dhe 4 mostra për teste të pajtueshmërisë. Nga mostrat e testuar nuk kemi vërejtur ndonjë mangësi domethënëse për raportim.

2.3 Detyrimet

2.3.1 Detyrimet e papaguara

Pasqyra e detyrimeve të papaguara ndaj furnitorëve në fund të vitit 2019, ishte 27,325€³. Këto detyrime janë bartur për t'u paguar në vitin 2020.

2.3.2 Detyrimet kontigjente

Detyrimet kontigjente në fund të vitit 2019, ishin zero 0.00€.

2.3.3 Detyrimet kontraktuale

Vlera e detyrime kontraktuale të GJKK-së në fund të vitit 2019 ishte 550,995€⁴. Përveç kësaj vlere, GJKK shfrytëzon edhe 6 kontrata të centralizuara të cilat i ka nënshkruar Autoriteti Qendror i Prokurimit. Nuk kemi vërejtur ndonjë mangësi domethënëse për raportim në fushën e detyrimeve.

2.4 Funkzioni i auditimit të brendshëm

Njësia e Auditimit të Brendshëm (NJAB) përbëhet nga një auditor (Drejtori i NJAB) i cili kishte të aprovuar planin vjetor dhe strategjik. NJAB për vitin 2019 kishte planifikuar dhe kryer pesë auditime të rregullta, duke përmbushur në tërësi planin e auditimit. Po ashtu, Komiteti i Auditimit në vitin 2019 kishte mbajtur katër takime. Nuk kemi vërejtur ndonjë mangësi domethënëse për raportim në këtë fushë.

3 Progresi në zbatimin e rekomandimeve

Raporti ynë i auditimit për PFV-të të vitit 2018 të GJKK-së ka rezultuar në 4 rekomandime kryesore. GJKK kishte përgatitur një Plan Veprimi ku paraqitet mënyra se si do t'i zbatojë rekomandimet e dhëna si dhe kishte raportuar për progresin e zbatimit të rekomandimeve.

Deri në fund të auditimit tonë për vitin 2019, GJKK kishte adresuar të gjitha rekomandimet. Për një përshkrim më të plotë të rekomandimeve dhe mënyrën se si janë trajtuar ato, shihni në Tabelën 3.

³ Kjo shumë është prezentuar nga entiteti i audituar

⁴ Kjo shumë është prezentuar nga entiteti i audituar

Tabela 3 Përmbledhja e rekomandimeve të vitit paraprak dhe vitit 2019

Nr.	Fusha e Auditimit	Rekomandimet e vitit 2018	Veprimet e ndërmarra	Statusi
1	Kërkesat tjera për raportim	Sekretari i Përgjithshëm duhet të siguroj që me rastin e prezantimit të pasurive jo kapitale nën 1,000€ në PFV-të, përfshihet vlera totale e pasurive të saj duke u siguruar se janë aplikuar normat e zhvlerësimit për të gjitha vitet. Deklarata e bërë nga Zyrtari Kryesor Administrativ dhe ai Financiar, nuk duhet të nënshkruhet përveç nëse ndaj pasqyrave financiare vjetore janë aplikuar të gjitha kontrollet e nevojshme.	Në këtë vit janë ndërmarr masa, pasuria është preznetuar drejtë.	I adresuar
2	Planifikim i dhe realizimi i buxhetit	Sekretari i Përgjithshëm duhet të siguroj se shpenzimet planifikohen dhe realizohen konform kategorive ekonomike adekuate, për të mundësuar raportimin e drejtë të tyre sipas standardeve të kontabilitetit të sektorit publik në përputhje me planin kontabël.	Nuk kemi identifikuar raste të tilla.	I adresuar
3	Paga dhe mëditje	Sekretari i Përgjithshëm duhet të siguroj vendosjen kontrolleve të shtuara për të parandaluar gabimet e identifikuar në mënyrë që rastet e tilla të mos përsëriten. Pagesat e kryera ndaj lehonave duhet të jenë në harmoni të plotë me kërkesat ligjore dhe vendimet përkatëse të GJKK-së.	Gjatë vitit dy raste kanë qenë në pushim të lehonise, dhe pagesat ishin bërë sipas kërkesave ligjore.	I adresuar
4	Paga dhe mëditje	Sekretari i Përgjithshëm duhet të siguroj që për ndryshimet e ndodhura në sistemin e pagesave të azhurnohen kontratat. Më tutje, me hyrjen në fuqi të ligjit të ri të pagave, në periudhën e azhurnimeve të kontratave të reja, të sigurohet se kontratat janë azhurnuar në përputhje me ligjin e pagave.	Lista e pagesave kemi verejtur që rekomandimi është adresuar në gjysmën e dytë të vitit 2019.	I adresuar
Nr.	Fusha e auditimit	Rekomandimet e vitit 2019	Nuk kemi rekomandime për vitin 2019	

Shtojca I: Shpjegim i llojeve të ndryshme të opinioneve të aplikuara nga ZKA-ja

(e shkëputur nga ISSAI 200)

Forma e opinionit

147. Auditori duhet të japë një **opinion të pamodifikuar** nëse arrin në përfundimin se Pasqyrat Financiare janë përgatitur në të gjitha aspektet materiale, në pajtim me kornizën e zbatueshme financiare.

Nëse auditori, bazuar mbi dëshmitë e marra të auditimit arrin në përfundimin se Pasqyrat Financiare si tërësi përmbajnë keqdeklarime materiale ose nuk arrin të marrë dëshmi të mjaftueshme auditimi për të nxjerrë përfundimin se pasqyrat financiare si tërësi nuk përmbajnë keqdeklarime materiale, atëherë ai duhet të modifikojë opinionin në raportin e auditorit sipas pjesës që flet për 'Përcaktimin e llojit të modifikimit që i bëhet opinionit të auditorit'.

148. Nëse pasqyrat financiare të përgatitura sipas kërkesave të një kornize për prezantim të drejtë nuk arrijnë të japin një paraqitje të drejtë, auditori duhet të diskutojë çështjen me menaxhmentin dhe, varësisht nga kërkesat e kornizës së zbatueshme për raportim financiar dhe nga mënyra se si zgjidhet çështja, të përcaktojë nëse është e nevojshme të modifikojë opinionin e auditimit.

Modifikimet që i bëhen opinionit në raportin e auditorit

151. Auditori duhet të modifikojë opinion në raportin e auditorit në rast se, duke u bazuar në dëshmitë e marra të auditimit arrin në përfundimin se Pasqyrat Financiare si tërësi përmbajnë gabime materiale, ose në qoftë se auditori nuk ka mundur të marrë dëshmi auditimi të mjaftueshme dhe të përshtatshme për të nxjerrë përfundimin se Pasqyrat Financiare si tërësi nuk përmbajnë keqdeklarime materiale. Auditorët mund të japin tri lloje opinionesh të modifikuara: opinion të kualifikuar, opinion të kundërt dhe mohim të opinionit.

Përcaktimi i llojit të modifikimit që i bëhet opinionit të auditorit

152. Vendimi se cili lloj i opinionit të modifikuar është i përshtatshëm varet nga:

- natyra e çështjes që i jep shkas modifikimit – d.m.th nëse Pasqyrat Financiare përmbajnë keqdeklarime materiale ose, në rast se ishte e pamundur për të marrë dëshmi auditimi të mjaftueshme dhe të përshtatshme, mund të përmbajnë keqdeklarime materiale; dhe
- gjykimi i auditorit rreth përhapjes së efekteve ose efekteve të mundshme që çështja ka në Pasqyrat Financiare.

153. Auditori duhet të japë një **opinion të kualifikuar nëse**: (1) pasi ka marrë dëshmi auditimi të mjaftueshme dhe të përshtatshme, auditori arrin në përfundimin se keqdeklarimet, ose individualisht ose së bashku, janë materiale, por nuk janë përhapur në Pasqyrat Financiare, ose (2) nëse auditori nuk ka mundur të marrë dëshmi auditimi të mjaftueshme dhe të përshtatshme në të

cilat të bazojë një opinion, por arrin në përfundimin se efektet e çdo gabimi të pazbuluar mbi Pasqyrat Financiare kanë mundur të jenë materiale, por jo të përhapura.

154. Auditori duhet të japë një **opinion të kundërt nëse**, pasi ka marrë dëshmi auditimi të mjaftueshme dhe të përshtatshme, auditori arrin në përfundimin se keqdeklarimet, ose individualisht ose së bashku, janë edhe materiale edhe të përhapura në Pasqyrat Financiare.

155. Auditori duhet japë **mohim të opinionit nëse**, pasi nuk ka mundur të marrë dëshmi auditimi të mjaftueshme dhe të përshtatshme në të cilat të bazojë një opinion, auditori arrin në përfundimin se efektet e çdo gabimi të pazbuluar mbi Pasqyrat Financiare kanë mundur të jenë, edhe materiale, edhe të përhapura. Nëse, pas pranimit të angazhimit, auditori bëhet i vetëdijshëm se menaxhmenti ka imponuar një kufizim të fushëveprimit të auditimit, për të cilin auditori konsideron se mund të rezultojë në nevojën për të shprehur një opinion të kualifikuar ose mohim opinionit mbi Pasqyrat Financiare, auditori duhet të kërkojë nga menaxhmenti ta heqë atë kufizimin.

156. Nëse auditori jep një opinion të modifikuar, ai duhet të modifikojë edhe titullin për të korresponduar me llojin e opinionit i shprehur. ISSAI 1705 jep udhëzime shtesë rreth gjuhës specifike që duhet përdorur kur jepet një opinion dhe për të përshkruar përgjegjësinë e auditorit. Ajo gjithashtu përfshin shembuj ilustrues të raporteve.

Paragrafët e Theksimit të Çështjes dhe paragrafët e Çështjeve të Tjera në raportin e auditorit

157. Nëse auditori e konsideron të nevojshme për të tërhequr vëmendjen e përdoruesve në një çështje të paraqitur ose shpalosur në pasqyrat financiare, e cila është sa e rëndësishme aq edhe thelbësore që ata të kuptojnë Pasqyrat Financiare, por ka prova të mjaftueshme e të përshtatshme se çështja nuk përmban keqdeklarime materiale në pasqyrat financiare, auditori duhet të përfshijë një paragraf të Theksimit të Çështjes në raportin e tij. Paragrafët për Theksimin e Çështjes duhen t'i referohen vetëm informacionit të paraqitur ose shpalosur në Pasqyrat Financiare.

158. Një paragraf i theksimit të çështjes duhet:

- të përfshihet menjëherë pas opinionit;
- të ketë titullin 'theksim i çështjes' ose ndonjë titull tjetër të përshtatshëm;
- të përmbajë një referencë të qartë ndaj çështjes që theksohet dhe të tregojë se në ç' pjesë të Pasqyrave Financiare mund të gjenden shpalosjet relevante që e përshkruajnë plotësisht çështjen; dhe
- të tregojë se opinionit i auditimit nuk është modifikuar për sa i përket çështjes të theksuar.

159. Nëse auditori e konsideron të nevojshme për ta komunikuar një çështje, përveç atyre që janë paraqitur ose shpalosur në Pasqyrat Financiare, e cila, në gjykimin e auditorit, është e rëndësishme për përdoruesit në mënyrë që ta kuptojnë auditimin, përgjegjësitë e auditorit apo raportin e auditimit, dhe me kusht që kjo nuk është e ndaluar me ligj ose rregullore, duhet të përpilohet një paragraf me titullin "Çështje Të Tjetra", apo ndonjë titull tjetër të përshtatshëm. Ky paragraf duhet të paraqitet menjëherë pas opinionit dhe pas çdo paragrafi të Theksimit të Çështjes.

Shtojca II: Letërkonfirmimi



REPUBLIKA E KOSOVËS - РЕПУБЛИКА КОСОВО - REPUBLIC OF KOSOVO
GJYKATA KUSHTETUESE
УСТАВНИ СУД
CONSTITUTIONAL COURT
SEKRETARIA / SEKRETARIJAT / SECRETARIAT

Prishtinë, më 1 qershor 2020
Nr. ref.: SP 936/20

LETËR E KONFIRMIMIT

Për: "Etika - Co" SHPK

Të nderuar,

Përmes kësaj shkrese, konfirmoj se:

- kam pranuar draft raportin e Auditorit për auditimin e Pasqyrave Financiare për Gjykatën Kushtetuese, për vitin 2019 (në tekstin e mëtejme "Raporti");
- pajtohem me përmbajtjen e Raportit;

Milot Vokshi

Sekretar i Përgjithshëm i Gjykatës Kushtetuese



Perandori Justinian 44, 10000 Prishtinë/a, Kosovë/o

Tel: +383 (0)38 606 162; Fax: +383 (0)38 606 170; www.gjk-ks.org